



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: Dep: Dep:	DPKI
Nr. i faq: Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot: Br Prot: Prot No	06-01/1944/20
Data: Datum: Date	25-09-2020



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.09.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-1741/20*, për zyrtarin e lartë z.Yll Çitaku, Anëtar i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës (QKK), për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK- 06-1741/20, e qe ka pasur të bëjë me zyrtarin e lartë z.Yll Çitaku, Anëtarë i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) është zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas pranimit të informacioneve nga një denoncuues i jashtëm është kërkuar nga Agjencia për të bërë vlerësimin e situatës së konfliktit të interesit, në lidhje me zyrtarin e lartë z.Yll Çitaku, Anëtarë i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) .

Pas vlerësimit të këtij informacioni dhe analizimit të situatës, në lidhje me pretendimet e ngritura, në pajtim me nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit nr.06/L-011, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1764/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z.Yll Çitaku, Anëtarë i Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK) për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.



Pas kësaj shkrese z.Yll Çitaku, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së, për tu njoftuar për situatën që është duke u zhvilluar.

Zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kanë shfrytëzuar kërkesën e zyrtarit z.Yll Çitaku, dhe kanë organizuar në zyrat e AKK-së një takim me të. Në këtë takim zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me pretendimet e ngritura si dhe me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për të, duke e njoftuar atë se figuron si person i autorizuar dhe përfaqësues i biznesit privatë me emër N.SH“OSO”, më të cilën kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë takim zyrtari i lartë z.Yll Çitaku, është pajtuar me gjendjen, duke treguar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet, por ka mbet vetëm i regjistruar, ndërsa ka theksuar se mund të sjell edhe dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës, që dëshmojnë se biznesi nuk zhvillon aktivitet, dhe se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar në këtë biznes.

Pas këtyre veprimeve nga zyrtari i lartë z.Yll Çitaku, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z.Yll Çitaku,nuk figuron të jetë person i autorizuar dhe përfaqësues i autorizuar në biznesin privatë me emër N.SH“OSO” .

Pas vlerësimit të fakteve dhe situatës me informacionet e siguruar lidhur me këtë rast, kemi arritur në përfundim se nuk janë gjetur prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e ngritura, por është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik sipas nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011.

Duke marrë parasysh se faktin se z.Yll Çitaku, ka ndërmarr veprimet e duhura duke hequr dorë nga të qenurit person i autorizuar dhe përfaqësues në biznesin privatë, si dhe duke u bazuar në vendimin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit(MKRS),të datës 28.08.2020 nr.108/2020,më të cilin janë emëruar anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës(QKK),u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

